VENDIM
Nr. 105, datë 5.10.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre"; të nenit 1 pika 4, shkronja "b" dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 44 dhe 45, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar; të nenit 66, pika 8, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet rregullorja "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve tyre", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 8.6.2005, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe Unioneve të tyre.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

a) ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji "për SHKK-të";

b) nenit 1, pika 4, shkronja "b", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

c) neneve 44 dhe 45, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar;

d) nenit 66, pika 8 e ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për SHKK-të dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e

mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) "kredi me probleme" – është totali i kredive (kryegjë dhe interes) të klasifikuara si "nënstandarde", "të dyshimta", "të humbura" dhe të ristrukturuara, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

b) "kredi me probleme neto" – është totali i kredisë me probleme (kryegjë dhe interes), duke zbritur fondin rezervë të krijuar për mbulimin e humbjeve nga këto kredi;

c) "ristrukturimi i kredisë" – është lehtësimi/et që SHKK-ja bën për kredimarrësin, vetëm për shkak të vështirësive financiare të tij, të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat përfshijnë në përgjithësi:

i) lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë, nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit,

ii) marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera, për shlyerjen e pjesshme të kredisë,

iii) zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një apo më shumë kredimarrësi shtesë;

d) "aktive likuide" – janë aktivet me maturim të mbetur deri në një muaj (depozita, bono thesari etj.) dhe pa maturim (arka, llogaria rrjedhëse etj.);

e) "pasive afatshkurtra" – janë pasivet me maturim të mbetur deri në një muaj;

f) "auditues ligjor" – do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar";

g) "shoqëria e auditimit" do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar";

h) "grup personash të lidhur" janë dy ose më shumë anëtarë ose persona, të cilët mund të përbëjnë një rrezik të vetëm për SHKK-në, për shkak se ata janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që përkeqësimi i situatës financiare të njërit prej tyre, mund të sjellë përballjen e tjetrit / të tjerëve me të njëjtën situatë, për shkak se humbja, fitimi ose aftësia paguese e njërit prej tyre mund të transferohet te tjetri / të tjerët.

KREU II
PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV

Neni 5
Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Organet drejtuese, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e SHKK-së, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të saj, duke përcaktuar/miratuar paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën ndaj tij (rrezikut), si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Organet drejtuese, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka si përparësi zbatimin e ligjit dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. SHKK-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve, në përputhje me aktet e saj të brendshme dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Neni 6
Sistemi i administrimit të rrezikut

1. SHKK-ja krijon dhe zhvillon sistemin e administrimit të rrezikut, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të SHKK-së, që shërbejnë për admi-nistrimin e rrezikut.

3. SHKK-ja, në hartimin e politikave për administrimin e rrezikut, siguron që këto politika të jenë të kuptueshme, të zbatueshme dhe të mirëpërcaktuara për çdo njësi/strukturë të SHKK-së.

4. Politikat për administrimin e rrezikut duhet të përfshijnë minimalisht elementet e mëposhtëm:

a) strukturën organizative dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e rrezikut;

b) detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës së administrimit të rrezikut;

c) metodën e vendosjes/përcaktimit të kufijve/normave të rrezikut dhe procedurat në rastet e shkeljes së këtyre kufijve/normave;

d) mënyrën e informimit dhe procedurat e raportimit;

e) miratimet dhe/ose konfirmimet, që duhet të jepen në rrethana të veçanta.

Neni 7
Njësia e kontrollit të brendshëm

1. SHKK-ja krijon një njësi të kontrollit të brendshëm, nëse plotësohet të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

a) përbëhet mesatarisht nga jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) anëtarë; ose

b) totali i aktiveve të bilancit tejkalon shumën prej 1 (një) miliardë lekësh.

2. Krijimi i njësisë së kontrollit të brendshëm bëhet me vendim të këshillit drejtues, në të cilin përcaktohen në mënyrë të qartë, përbërja dhe rregullat e funksionimit të njësisë.

Neni 8
Politikat e shpërblimit

1. Këshilli drejtues, në përputhje me strategjinë, objektivat afatgjatë të veprimtarisë së SHKK-së dhe ecurinë e saj, përcakton qartë dhe miraton politikat e shpërblimit.

2. SHKK-ja përfshin në raportin vjetor të qeverisjes, që i paraqitet asamblesë së përgjithshme nga organet drejtuese, politikat e shpërblimit, si dhe shumat vjetore të agreguara të shpërblimeve për anëtarët e këshillit drejtues dhe administratorin, duke shpjeguar dhe argumentuar përputhshmërinë e këtyre pagesave me politikat e administrimit të rrezikut dhe profilin e rrezikut, të përcaktuar sipas objektivave afatgjatë të SHKK-së.

KREU III
ADMINISTRIMI I RREZIQEVE

NËNKREU I
EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET

Neni 9
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit

1. SHKK-ja siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit, për ushtrimin e një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme, si edhe për përmbushjen e detyrimeve të saj.

2. SHKK-ja respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtëm:

a) raporti në përqindje i kapitalit ndaj zërave të aktivit të bilancit dhe të zërave jashtë bilancit, të ponderuara me rrezik, nuk duhet të jetë më pak se 10% (dhjetë për qind) gjatë dy viteve të para të ushtrimit të veprimtarisë dhe në çdo kohë jo më pak se 12% (dymbëdhjetë për qind);

b) raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c) raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme (neto) të pagarantuara me bllokim depozite, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Në raste të veçanta, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë për një SHKK, një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit më të lartë sesa raporti i përcaktuar në pikën 2, shkronja "a" të këtij neni, nëse konstaton se SHKK-ja përfshihet në veprimtari me rrezik të lartë.

4. SHKK-ja klasifikon çdo ekspozim të zërave brenda dhe jashtë bilancit, siç përcaktohet në formularët 1/1 dhe 1/2 të kësaj rregulloreje.

5. SHKK–ja llogarit vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve.

6. SHKK-ja, në rastet kur ekspozimi garantohet me një nga format e mëposhtme të mbrojtjes së rrezikut të kredisë, zbret nga vlera e ekspozimit përkatësisht:

a) depozitën monetare ose certifikatën e depozitës deri në shumën që garanton ekspozimin;

b) titujt e qeverisë shqiptare, të emetuara në monedhë kombëtare; dhe/ose

c) garanci të patjetërsueshme të qeverisë shqiptare.

7. Në rastet e mosrespektimit të raportit të përcaktuar në pikën 2, shkronja "a", të këtij neni, përveç zbatimit të masave mbikëqyrëse, sipas nenit 32 të kësaj rregulloreje, ndaj SHKK-së aplikohet primi shtesë për sigurimin e depozitave, sipas parashikimeve të nenit 66, pika 8, të ligjit "Për sigurimin e depozitave".

Neni 10

Kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh

1. Ekspozimi i SHKK-së ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, është shuma e të gjitha marrëdhënieve në aktiv të bilancit dhe të angazhimeve jashtë bilancit me këtë person ose grup personash.

2. Ekspozimi i SHKK-së ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, konsiderohet ekspozim i madh, kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10% (dhjetë) për qind e kapitalit të SHKK-së.

3. Ekspozimi i SHKK-së ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, nuk mund të tejkalojë 20% (njëzet për qind) të kapitalit të SHKK-së.

4. Përjashtim nga kufizimi i pikës 3 të këtij neni, bën ekspozimi i SHKK-së ndaj një anëtari, i cili nuk mund të tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të SHKK-së.

5. SHKK-ja nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat, të marra së bashku, tejkalojnë 600% (gjashtëqind për qind) të kapitalit të saj.

6. Në ekspozimin e SHKK-së ndaj një personi ose grupi personash të lidhur nuk përfshihen:

a) pretendimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të siguruara me barrë siguruese mbi një depozitë monetare ose certifikatë depozite, deri në shumën e kësaj barre siguruese;

b) tituj të qeverisë shqiptare të emetuara në monedhë kombëtare;

c) garanci të patjetërsueshme të qeverisë shqiptare.

7. SHKK-ja, për qëllime të llogaritjes, raportimit dhe respektimit të kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha, përfshin në shuma të reduktuara me 80% (tetëdhjetë për qind) të ekspozimit, të drejtat ndaj bankave që veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe Unionit të SHKK-së.

8. SHKK-ja harton procedura të brendshme dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm, për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.

Neni 11

Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni i hapur valutor në një monedhë të huaj të caktuar, përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të SHKK-së, në këtë monedhë.

2. SHKK-ja llogarit dhe respekton normat e mëposhtme për pozicionet e hapura valutore, në baza mujore, përkatësisht:

a) raportin e pozicionit të hapur valutor për një monedhë të huaj me kapitalin, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind); dhe

b) raportin e pozicionit të hapur valutor për të gjitha monedhat me kapitalin, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind).

3. Në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor nuk përfshihet pozicioni strukturor në valutë, i cili është pozicioni që krijohet nga:

a) elemente (zëra të bilancit ose jashtë bilancit), të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore financiare të SHKK-së dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata të tilla si: "interesa pjesëmarrës"; "aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara" etj.;

b) transaksione të SHKK-së, të cilat ruajnë nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit, në rastet kur raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Neni 12

Huamarrjet

Shuma e huave të marra nga shoqëria e kursim-kreditit nuk duhet të tejkalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të totalit të aktiveve.

NËNKREU II

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË

Neni 13

Rreziku i kredisë

1. SHKK-ja miraton dokumentet e strategjive, politikave, procedurave dhe rregullave të brendshme, për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Dokumentet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përmbajnë minimalisht:

a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realistë në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë

etj.;

b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;

c) rregullat e vendosur për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;

d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si dhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë së strukturave miratuese;

e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për kategori të veçanta klientësh, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, analizën e mospërputhjeve të ndjeshme mes portofolit të kredisë dhe burimeve të financimit të tij përsa i takon afateve dhe llojit të monedhës;

f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive dhe identifikimin e tyre, sipas grupeve të kredive me karakteristika të njëjta, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë, kriteret për ristrukturimin e kredive etj.

3. SHKK-ja ruan në dosje të veçanta, të gjithë dokumentacionin përkatës për kredimarrësit.

4. Raporti midis totalit të kredive me probleme dhe totalit të portofolit të kredive, nuk duhet të jetë në asnjë rast më i madh se 10% (dhjetë për qind).

5. Unioni i SHKK-ve mund t'u japë kredi shoqërive të kursim-kreditit, anëtare në Union, brenda një kufiri dhe për një periudhë të caktuar, siç përcaktohet në marrëveshjen midis palëve. Marrëveshja e kredisë midis Unionit dhe shoqërive të kursim-kreditit rinovohet të paktën një herë në vit.

6. Unioni llogarit një fond rezervë prej 2% (dy për qind) të shumës së përdorur të kredisë së parashikuar në pikën 5 të këtij neni, dhe në rastet kur SHKK-ja është në shkelje të pikës 4 të këtij neni, Unioni llogarit një fond rezervë jo më të vogël se 30% (tridhjetë për qind) të shumës së përdorur.

7. Në rastet e mosrespektimit të raportit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, përveç zbatimit të masave mbikëqyrëse sipas nenit 32 të kësaj rregulloreje, ndaj SHKK-së aplikohet primi shtesë për sigurimin e depozitave, sipas parashikimeve të nenit 66, pika 8 të ligjit "Për sigurimin e depozitave".

Neni 14

Klasifikimi i kredisë

1. SHKK-ja, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, bën klasifikimin e kredisë, të paktën një herë në tre muaj, në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) "kredi standarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë, janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

b) "kredi në ndjekje", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit në të ardhmen,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

c) "kredi nënstandarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose subjekti nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) "kredi të dyshimta", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve - kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit "në paaftësi paguese/i falimentuar", vlerësohet si një mundësi reale,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) "kredi të humbura", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të

shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose SHKK-ja ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,

ii) kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

2. SHKK-ja, në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, e klasifikon kredinë në kategorinë më të ulët.

3. SHKK-ja, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bën klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

Neni 15

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. SHKK-ja, në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, krijon fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

a) për "kredinë standarde".....jo më pak se 2% (dy për qind);

b) për "kredinë në ndjekje".....jo më pak se 15% (pesëmbëdhjetë për qind);

c) për "kredinë nënstandarde".....jo më pak se 40% (dyzetë për qind);

d) për "kredinë e dyshimtë" .....jo më pak se 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind);

e) për "kredinë e humbur".....100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për të dyja kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kreditë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. SHKK-ja nuk kontabilizon interesat e përllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

5. Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve për kreditë e ristrukturuara, llogariten në mënyrë të njëjtë si për kreditë me probleme.

Neni 16

Ristrukturimi i kredisë

1. SHKK-ja, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojë kredinë sipas kritereve të përcaktuara në aktet e brendshme rregullative, të miratuara nga këshilli drejtues. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet edhe kur, mbështetur në analizat e saj, SHKK-ja gjykon se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori, nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit dhe, në çdo rast, jo më lart se kategoria "nënstandard", deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt kështet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e ristrukturimit;

b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) këste (kryegjë dhe interes).

3. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë kre.

4. Nëse kredia e ristrukturuar ka vonesa mbi 30 (tridhjetë) ditë, ajo do të klasifikohet si "e humbur".

Neni 17

Fshirja e kredive të humbura nga bilanci

1. Fshirja e kredive të humbura nga bilanci bëhet me vendim të këshillit drejtues të SHKK-së.

2. Në çdo rast SHKK-ja fshin kreditë nga bilanci, jo më vonë se 3 (tre) vite pas klasifikimit të tyre në klasën "të humbura".

3. Dosjet e kredive të fshira nga bilanci, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga këshilli drejtues i SHKK-së.

4. SHKK-ja, pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për

arkëtimin e këtyre kredive. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira, konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

Neni 18
Klasifikimi i kontratave të qirasë financiare

1. SHKK-ja që ushtron edhe veprimtarinë e qirasë financiare, bën klasifikimin e kontratave të qirasë financiare të paktën një herë në 3 (tre) muaj.

2. SHKK-ja, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kontratës së qirasë financiare, i klasifikon ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) "standarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

b) "në ndjekje", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

c) "nënstandarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

d) "të dyshimta", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

e) "të humbura", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

Neni 19
Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kontratat e qirasë financiare

1. SHKK-ja, në varësi të kategorive të klasifikimit, krijon fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga mospagimi i kontratave të qirasë financiare.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen përkatësisht si më poshtë:

a) për "kategorinë standarde".....jo më pak se 1% (një për qind);

b) për "kategorinë në ndjekje".....jo më pak se 5% (pesë për qind);

c) për "kategorinë nënstandarde".....jo më pak se 20% (njëzet për qind);

d) për "kategorinë e dyshimtë".....jo më pak se 20% (njëzet për qind);

e) për "kategorinë e humbur".....jo më pak se 20% (njëzet për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve, për të dyja kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kategoritë e përcaktuara në shkronjat "c", "d" dhe "e", norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. SHKK-ja nuk kontabilizon interesat e përllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kontratës së qirasë në kategorinë "nënstandarde".

NËNKREU III
ADMINISTRIMI I RREZIQEVE TË TJERA

Neni 20
Rreziku i likuiditetit

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare, si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen, dhe/ose kur SHKK-ja nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. SHKK-ja krijon sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim administrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e këtij rreziku, funksionin e kontrollit të brendshëm të administrimit të rrezikut të likuiditetit (nëse është i aplikueshëm), sistemin e informacionit etj.

3. SHKK-ja respekton në çdo kohë raportin e:

a) aktiveve likuide ndaj totalit të depozitave dhe huamarrjeve, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 7% (shtatë për qind);

b) aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 100% (njëqind për qind).

4. SHKK-ja nuk mund të japë kredi me afat mbi 5 (pesë) vjet, nëse shuma e kredisë që do të jepet tejkalon të paktën një nga kufijtë e mëposhtëm:

a) 100% (njëqind për qind) të kapitalit, pasi janë zbritur aktivet e qëndrueshme;
b) 10% (dhjetë për qind) të totalit të depozitave;
c) 100% (njëqind për qind) të detyrimeve me afat mbi 5 (pesë) vjet.

SHKK-ja përcakton në politikat e saj të brendshme, fushat e kreditimit për kreditë me afat mbi 5 (pesë) vjet.

5. SHKK-ja nuk mund të japë asnjë kredi me afat mbi 5 (pesë) vjet, gjatë 2 (dy) viteve të para të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

6. SHKK-ja nuk mund të japë asnjë kredi me afat mbi 10 (dhjetë) vjet. Përjashtim nga kjo pikë bëjnë kreditë e dhëna nga SHKK-ja me afat mbi 10 (dhjetë) vjet, të cilat mund të garantohen me të paktën një nga mjetet e mëposhtme:
a) depozitë monetare ose certifikatë depozite;
b) tituj të qeverisë shqiptare të emetuara në monedhë kombëtare;
c) garanci të dhëna nga institucione të licencuara ose të specializuara për këtë qëllim;
d) pasuri të paluajtshme.

7. Shuma e të gjitha kredive mbi 10 (dhjetë) vjet, të garantuara sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se 10% (dhjetë për qind) e totalit të portofolit të kredive të SHKK-së.

Neni 21
Administrimi i rrezikut operacional

SHKK-ja është subjekt i zbatueshmërisë së kërkesave për administrimin e rrezikut operacional të përcaktuara në rregulloren "Për administrimin e rrezikut operacional".

Neni 22
Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit

SHKK-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, zbaton kërkesat e rregullores "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë".

Neni 23
Parandalimi i pastrimit të parave

SHKK-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, zbaton kërkesat e ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", si dhe të rregullores "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

KREU IV
TRANSPARENCA ME ANËTARËT

Neni 24
Kërkesa të përgjithshme

1. SHKK-ja publikon dukshëm dhe qartësisht në ambientet e punës dhe/ose në faqen e saj të internetit, informacionin mbi normat e interesit të kredive dhe depozitave, si dhe komisionet për produktet dhe shërbimet që ajo ofron për kredimarrësit.

2. SHKK-ja sigurohet që informacioni, afatet, kushtet e produkteve dhe shërbimeve, si dhe të drejtat e përgjegjësitë e kredimarrësit, të jenë të plota e të sakta, dhe në një gjuhë të kuptueshme për kredimarrësin.

3. SHKK-ja i paraqet paraprakisht kredi-marrësit, përpara se ai të zgjedhë një produkt ose shërbim, një informacion të plotë për kushtet, afatet dhe normat në përqindje të interesit, për rreziqet që shoqërojnë marrjen e produktit apo shërbimit, si dhe komisionet e gjobat (penalitetet), në rastet kur këto të fundit bëhen të aplikueshme etj.

4. Në rastet kur SHKK-ja ndryshon kushtet e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve, ajo duhet t'ua njoftojë ndryshimet e reja anëtarëve të saj, me shkrim, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, ose nëpërmjet publikimit pranë ambienteve të punës ose në faqen zyrtare të internetit. Ky njoftim, duhet të kryhet përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme, si dhe duhet të përmbajë informacion të saktë, të plotë dhe të shprehur në një gjuhë të kuptueshme për kredimarrësin.

5. SHKK-ja nuk mund të ndryshojë, pa pëlqimin e kredimarrësit, gjatë kohëzgjatjes së

kontratës/marrëveshjes së kredisë metodën / metodologjinë e llogaritjes së normës së interesit dhe/ose elementet përbërëse të saj, për të cilën/at është rënë dakord me kredimarrësin në momentin e lidhjes së marrëveshjes/kontratës së kredisë.

Neni 25

Elementet e kontratës së kredisë

1. Kontrata e kredisë bëhet në të gjitha rastet me shkrim dhe duhet të ketë një formulim të kuptueshëm në gjuhën shqipe dhe një paraqitje të qartë dhe të dallueshme. Shkrimi i përdorur duhet të jetë "Times New Roman", me madhësi të paktën 10. Një kopje e kontratës së nënshkruar nga palët, i jepet personalisht kredimarrësit, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2. SHKK-ja dhe kredimarrësi nënshkruajnë një marrëveshje (kontratë) me shkrim për çdo kredi, e cila përfshin elementet e mëposhtme:

a) qëllimin e përdorimit të kredisë;

b) llojin e kredisë;

c) të dhëna të plota për identitetin dhe adresat e palëve kontraktore;

d) vlerën totale të kredisë dhe kushtet për lëvrimin e saj;

e) afatin e maturimit të kredisë;

f) normën e interesit, kushtet që përcaktojnë mënyrën e zbatimit dhe përllogaritjes së kësaj norme, çdo indeks ose normë reference të zbatueshme, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit, duke përcaktuar dhe mënyrën e njoftimit të kredimarrësit dhe/ose garantorit për çdo ndryshim të mundshëm;

g) kontributin fillestar të kredimarrësit (nëse është e zbatueshme) ose komisione të ndryshme për marrjen dhe shlyerjen e kredisë;

h) llojin e kolateralit (nëse ka);

i) detyrimet dhe penalitetet e palëve dhe rastet kur ato lindin e zbatohen, veçanërisht kur subjekt i tyre është kredimarrësi;

j) mënyrën e ndryshimit të kushteve të kontratës;

k) mënyrën e marrjes së pëlqimit të kredimarrësit në rastin e ndryshimeve të kushteve të kontratës;

l) mënyrën e përfundimit të kontratës;

m) shumën e kështit, numrin dhe periodicitetin ose datat e çdo kësti (pagesave të kredimarrësit) për të shlyer kredinë, dhe çdo shpenzim tjetër lidhur me dhënien dhe përdorimin e kredisë, të paraqitur në një plan shlyerjeje të kredisë (kryegjë dhe interes);

n) garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme);

o) të drejtën për shlyerjen e kredisë para afatit dhe të përfitimit të një reduktimi të kostos totale të kredisë;

p) numrin e kopjeve të nënshkruara në origjinal të kontratës dhe mënyrën e disponimit të tyre nga palët;

q) penalitetet lidhur me mosrespektimin e detyrimeve kontraktore, të cilat paguhen nga kredimarrësi, shuma e të cilave nuk tejkalon në asnjë rast shumën e detyrimit kontraktor.

3. SHKK-ja mund të përfshijë në kontratë me vullnetin e saj, edhe informacion tjetër shtesë, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Në procesin e lëvrimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, SHKK-ja i ofron kredimarrësit:

a) planin e shlyerjeve të kredisë në momentin e lëvrimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;

b) planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëzgjatjes së saj;

c) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarrësit dhe shembuj të mënyrës së llogaritjes së tyre.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet në rastin e shlyerjes (pagesës) së kredisë para afatit të maturimit

1. Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para afatit të maturimit, shlyerje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve të tij, të lindura nga kontrata e kredisë. Në këtë rast, SHKK-ja duhet të bëjë reduktim të kostos totale të kredisë. Ky reduktim konsiston në uljen e shumës së interesit dhe shpenzimeve të tjera të aplikueshme për shumën e kryegjësë së shlyer para afatit të maturimit, siç është rënë dakord në kontratën e kredisë për të tilla raste.

2. SHKK-ja ka të drejtën për një kompensim të drejtë dhe objektiv, që nuk mund të tejkalojë në asnjë

rast:

i) humbjet financiare të SHKK-së, të cilat duhet të jenë të justifikuara nga kosto të mundshme të lidhura direkt me shlyerjen/et e kredisë para afatit;

ii) 1% (një për qind) të shumës së kredisë së paguar para afatit.

Neni 27

Elementet e kontratës së depozitës

1. SHKK-ja dhe anëtari nënshkruajnë një marrëveshje (kontratë) për çdo depozitë me afat pranë SHKK-së.

2. Në kontratën e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të anëtarit, përfshihen:

a) shuma e investuar në depozitën me afat;

b) norma vjetore e interesit;

c) shumat e interesit dhe frekuenca e pagesës së tyre;

d) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;

e) data e maturimit të depozitës;

f) kushtet e zgjedhura nga kredimarrësi për rinovimin e depozitës me afat;

g) kushtet e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës; dhe

h) penalitetet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës.

3. SHKK-ja duhet të parashikojë në kontratën e depozitës, mënyrën e njoftimit të depozituesit për ndryshimin e kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar, para se të aplikojë ndryshimin.

4. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të treguara në pikën 2 të këtij neni, vetëm për një anëtar ose një grup të kufizuar anëtarësh, SHKK-ja është e detyruar të njoftojë paraprakisht me shkrim anëtarin/ët. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të lartpërmendura të kontratës së depozitës, që prek në mënyrë të njëjtë të gjithë anëtarët si rrjedhojë e politikave të SHKK-së, kjo e fundit është e detyruar të njoftojë paraprakisht secilin prej tyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

5. SHKK-ja është e detyruar t'i japë anëtarit informacion bazë mbi depozitat e tij, të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

KREU V

KËRKESAT RAPORTUESE DHE MASAT MBIKËQYRËSE

Neni 28

Raportet financiare

1. SHKK-ja mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së saj financiare, mbi baza individuale dhe në rastin e Unioneve, edhe në mënyrë të përmbledhur.

2. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

3. SHKK-ja harton politikat dhe procedurat kontabël të brendshme, të miratuara nga këshilli drejtues.

Neni 29

Auditimi ligjor

1. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të SHKK-së, me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, kontrollon dhe vlerëson:

a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);

b) bilancin kontabël;

c) raportin për ndryshimet në kapital;

d) pasqyrën e cash – flow;

e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;

f) raportet e konsoliduara (për Unionin);

g) funksionin e kontrollit të brendshëm (nëse është i aplikueshëm);

h) regjistrimet kontabël;

i) sistemet e informacionit;

j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;

k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;

l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

3. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, verifikon saktësinë e mbajtjes së llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe përgatit një raport vjetor, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të SHKK-së, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga SHKK-ja, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

4. SHKK-ja emëron një shoqëri auditimi, në rastet kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) numri i anëtarëve të SHKK-së është mesatarisht jo më i vogël se 10,000 (dhjetë mijë) anëtarë, gjatë periudhës kontabël; ose

b) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, tejkalon shumën prej 1 (një) miliardë lekësh.

Neni 30

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. SHKK-ja raporton në Bankën e Shqipërisë, në periudha tremujore, sipas kërkesave të përcaktuara në "Sistemin raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Të dhënat raportohen jo më vonë se 50 (pesëdhjetë) ditë pas mbylljes së tremujorit përkatës.

2. Unioni raporton sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe për të gjitha SHKK-të anëtare të tij, mbi baza individuale dhe në mënyrë të përmbledhur.

3. SHKK-ja që nuk është anëtare e një Unioni dhe rezulton me shkelje të normave mbikëqyrëse, duhet të raportojë në Bankën e Shqipërisë çdo muaj.

4. Unioni raporton në Bankën e Shqipërisë normat mbikëqyrëse të shoqërive të kursim-kreditit që rezultojnë me shkelje të tyre.

5. SHKK-ja dërgon në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe një kopje të opinionit të audituesit ligjor, ose shoqërisë së auditimit, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël, mbi baza individuale dhe në rastin e Unionit, edhe në mënyrë të përmbledhur.

6. Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e procesit të saj mbikëqyrës, mund të kërkojë në çdo kohë edhe raportime më të shpeshta nga SHKK-të dhe Unionet.

Neni 31

Regjistri i Kredive

1. SHKK-ja raporton në Bankën e Shqipërisë informacionin e kërkuar nga kjo e fundit, për qëllim të Regjistrit të Kredive, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. SHKK-të dhe Unionet e tyre kanë të drejtë të përdorin informacionin e mbajtur në Regjistrin e Kredive, sipas rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 32

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në ligjin për SHKK-të.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Dispozitë kalimtare

1. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa që treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të jetë mbi nivelin e përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, brenda datës 30 qershor 2018.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore, brenda datës 30 qershor 2017.

3. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa që të kontabilizojnë mbi baza të përllogaritura interesat e kredive dhe të llogaritin fondet rezervë për këto interesa, brenda datës 30 qershor 2021.

4. Kërkesat e parashikuara në këtë rregullore për veprimtarinë e SHKK-ve, zbatohen edhe për Unionin, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKSI 1

FORMULARI NR. 1/1

ZËRAT E AKTIVIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN	Vlera kontabël	Koeficienti i ponderimit	Vlera e ponderuar
1. Aktivet pa rrezik me koeficient ponderimi 0%:		0%	
Arka dhe zërat e ngjashëm me të		0%	
Tituj të qeverisë shqiptare të emetuar në monedhën kombëtare		0%	
Aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme, si vijon : depozitë ose certifikatë depozite, deri në shumën që garanton ekspozimin; tituj të qeverisë shqiptare, të emetuara në monedhë kombëtare; garanci të patjetërsueshme të qeverisë shqiptare.		0%	
2. Aktive me rrezik të ulët me koeficient ponderimi 20%:		20%	
Të drejta ndaj bankave që veprojnë në Republikën e Shqipërisë		20%	
Të drejta ndaj Unionit të SHKK-së.		20%	
3. Aktive me rrezik të mesëm me koeficient ponderimi 50%:		50%	
Kredi hipotekare dhënë anëtarëve për përmirësimin e kushteve të banimit (për blerjen ose rikonstruksionin e banesës, e cila garantohet me hipotekë)		50%	
Kredi me afat maturimi deri në 12 muaj		50%	
Qira financiare		50%	
4. Aktive me rrezik të lartë, me koeficient ponderimi 100%:		100%	
Kredi të tjera ndaj anëtarëve, përveç atyre të klasifikuara në pikat 1 dhe 3		100%	
Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara		100%	
Aktive të tjera të paklasifikuara sipas pikave 1, 2 dhe 3		100%	
TOTALI I AKTIVEVE TË PONDERUARA ME RREZIKUN			

FORMULARI NR. 1/2

ZËRAT E AKTIVIT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN	Vlera kontabël	Koeficienti i ponderimit	Vlera e ponderuar
1. Zërat jashtë bilancit me rrezik të lartë me koeficient ponderimi 100%:		100%	
Angazhime financimi të dhëna		100%	
Garanci të dhëna		100%	
Tituj të dhënë si garanci për kredi ose rifinancim		100%	
Valutë e blerë me afat		100%	
Shuma për t'u marrë në lekë kundrejt shitjes së valutave		100%	
Angazhime të tjera		100%	
TOTALI I ZËRAVE JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN			

FORMULARI NR. 1/3

Kodi	**RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT**	
1	Totali i zërave të aktivit të ponderuara me rrezikun	
2	Totali i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	
3	**Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun (1+2)**	

4	Kapitali i SHKK-së	
5	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (4/3)*100	
6	Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit	12%